



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr. 484/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM, gjyqtarja Violeta Husaj Rugova me sekretaren juridike Tringa Zhuti, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. Ć, sipas aktakuzës së PTH në Pejë PP. II .nr. 742/17 të dt. 25.04.2017, për vepre penale: përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të mbajtur në praninë e prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi, të pandehurit S. Ć, mbrojtësit të tij av. O. C., me dt. 03.07.2017 mori dhe me dt.16.07.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari

S. Ć, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr..... boshnjak, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 05.02.2017, rreth orës 18:30, në fshatin V, Komuna Pejë, pikërisht pranë restorantit “E” në V, në gjendje të dehur ka përdorur armën zyrtare të llojit “.....” me numër serik, në atë mënyrë që ditën kritike pasi që i pandehuri kishte konsumuar alkool për shkak të disa problemeve shëndetësore, në shenjë dëshpërimi kishte shtënë përpjetë duke shkarkuar 15 plumba, ku armën e hedh në tokë, ku e njëjta armë është gjetur dhe sekuestruar nga ana e policisë,

-me çka ka kryer vepër penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 41, 42, 46, dhe nenit 375 par. 1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarit të lartcekur i përcaktohet dënimi me gjobë në shumë prej 450 €, të cilin dënim obligohet që ta paguaj me se largu ne afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg në kohëzgjatje prej 15 ditësh ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore gjykatës dhe paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritë aktakuzë PP. II .nr. 742/17 të dt. 25.04.2017, ndaj të akuzuarit Safet Čivović, sipas aktakuzës së PTH në Pejë PP. II .nr. 742/17 të dt. 25.04.2017, për vepre penale: përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Prokurori bashkë me aktakuzën i ka dërguar gjykatës edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë, me këtë rast gjykata ka caktuar seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes.

Në seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes kanë prezantuar prokuroria e shtetit Sanije Gashi Seferi, i akuzuari S. Č. dhe mbrojtësi i tij av. O. C. dhe është bërë e ditur përkatësisht është konfirmuar se: i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit me dt. 26.04.2017 kanë lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe të njëjtën marrëveshje sërish e kanë konfirmuar edhe në shqyrtimin gjyqësor, dhe këtë marrëveshje gjyqtarja e ka pranuar – e bindur thellë se marrëveshja e tillë është bërë konform dispozitave të Kodit të procedurës Penale dhe të Kodit Penal të Republikës së Kosovës .

Pasi që u aprovua përkatësisht u pranua marrëveshja mbi pranimin e fajësisë gjyqtarja e konfirmoj edhe vendimin mbi masën ndëshkuese brenda kufijve të paraparë me marrëveshje si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 450 të akuzuarin e obligon në paguarjen e shpenzimeve procedurale.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr. 484/17 datë 16.07.2017

Sekretarja Juridike
Tringa Zhuti

Gj y q t a r j a
Violeta Husaj Rugova

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate